

UNIVERSITETI I MJEKESISE, TIRANE



MASTER PROFESIONAL

“INFIRMIERI FAMILJE”



Përmbajtja

Misioni	4
Vizioni	4
Përshkrimi i programit Master	5
Pse duhet të zgjedh Masterin Profesional “Infermieri familje”	6
Kriteret e pranimit	8
Programi i studimit	9
Lëndët	
1. Infermieri e Bazuar në Evidencë	10
2. Infermieristika në familje. Konceptet, teoritë dhe aplikimet e saj	10
3. Menaxhimi i Sëmundjeve Kronike	11
4. Promocioni Shëndetësor	11
5. Infermiera e familjes në popullata specifike	12
6. Vlerësimi klinik	12
7. Terapia e punës, Ergoterapia (lëndë me zgjedhje)	13
8. Semiotika në Logopedi (lëndë me zgjedhje)	13
9. Praktika	14
Mbështetja e Projektit Shëndet për të Gjithë	15

Të dhëna kryesore:

Cikli i studimeve:	Program studimi i ciklit të dytë
Emërtimi i Diplomës:	Master Profesional “Infermieri familje”
Kohëzgjatja:	1 vit akademik
Sistemi i studimit:	Me kohë të plotë (<i>i përshtatshëm për ata që janë në marrëdhënie pune</i>)
Kredite:	60 ECTS
Gjuha:	Shqip
Tarifa e shkollimit:	76,000 lekë (përfshirë tarifën e aplikimit dhe regjistrimit)





Misioni

Programi Master Profesional “Infermieri familje” synon të formojë personel infermior të kualifikuar, që të ofrojnë cilësinë më të lartë të kujdesit për pacientët, familjen e tyre dhe komunitetin. Programi u mundëson praktikimin e standardeve të larta, duke u mbështetur tek vlerat e traditës dhe në praktikatat më të mira në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për kujdesin shëndetësor.

Vizioni

Të zhvillojë aftësi në këshillimin, parandalimin e sëmundjeve, rehabilitimin dhe kujdesin infermior të pacientëve dhe anëtarëve të familjes së tyre në Kujdesin Shëndetësor Parësor (KSHP) dhe në banesë.

Përshkrimi i Programit Master

Programi i studimit Master Profesional “Infermieri Familje” është një program pasuniversitar që ofrohet për herë të parë nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike (FSHMT) dhe si i tillë është programi i vetëm i këtij lloji në Shqipëri. Ky program është hartuar për të plotësuar profilin e ri të infermierit të familjes, si domosdoshmëri, për t’ju përgjigjur nevojës në rritje për shërbim të kualifikuar në banesë, trajtimin të sëmundjeve kronike jo-të transmetueshme dhe prirjes për plakjen e popullatës.

Kurrikula e programit është hartuar me ekspertizën e institucioneve arsimore të profilit të shkencave mjekësore teknike të Bazelit (Zvicër) dhe ofron integrimin e teorisë dhe praktikës me një vëmendje të shtuar tek praktika. Studentët fitojnë aftësi të shumta praktike që zhvillohen në laboratorin e ri simulues të praktikës klinike të FSHMT dhe praktikave profesionale në Qendrat Shëndetësore të Kujdesit Parësor. Lëndët e programit do të përcillen nga pedagogë infermierë.

Pas përfundimit me sukses të programit, studentët do të marrin diplomën në Master Profesional “Infermieri Familje” dhe kualifikimin e specializuar të Infermierit të Familjes.



Pse Duhet të Zgjedh Masterin Profesional “Infermieri Familje”

●● Personel akademik infermior, ●● trajnuar nga ekspertë ndërkombëtarë

I gjithë stafi pedagogjik përgjegjës për masterin “Infermieri Familje” është me formim infermior, çka përbën një prej risive të këtij programi. Pedagogët janë trajnuar nga ekspertë të universiteteve zvicerane dhe hollandeze, të specializuar në programe infermieristike.

●● Formim praktik ●● i studentëve

Programi mundëson kryerjen e praktikës mësimore për studentët në laboratorin e ri simulues të Fakultetit, i cili është i pajisur me pajisjet trajnuese si manekine me simulim dhe pajisjet e domosdoshme mjekësore që nxisin zhvillimin e aftësive të studentëve për vlerësimin klinik si dhe praktikimin e procedurave të ndryshme infermiore.

Studentët do të fitojnë aftësi të shtuara praktike përmes punës dhe praktikave profesionale në Qendrat Shëndetësore me të cilat Fakulteti ka marrëveshje bashkëpunimi. Këto praktika do të udhëhiqen nga supervizorët e praktikës dhe ekipet infermiore të këtyre QSH-ve.





Kurrikul bashkëkohore, bazuar në kompetenca

Kurrikula është hartuar në bashkëpunim me ekspertë ndërkombëtarë dhe në përputhje të plotë me strategjinë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Universitetit të Mjekësisë. Kurrikula është bazuar në kompetencat e nxjerra nga përkufizimi i Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe Bashkimit Europian për rolin shumëplanësh të Infermierit të Familjes.

Program në përgjigje të nevojave të popullatës

Programi është në përgjigje të nevojave të popullsisë shqiptare për shërbim të specializuar infermior në familje nisur nga rritja e sëmundshmërisë kronike dhe plakja e popullsisë. Qendrat e kujdesit shëndetësor parësor kanë nevojë për profilin e infermierit të familjes, si përgjigje ndaj prirjeve demografike dhe epidemiologjike, dhe në përmbushje të detyrave të përcaktuara në Paketën Bazë të Shërbimeve të KSHP.

Në Strategjinë Kombëtare të Kujdesit Shëndetësor Parësor 2020-2025 parashikohet që 50 infermierë të familjes që operojnë në Kujdesin Shëndetësor Parësor të kenë përfunduar Programin e ri Master Profesional “Infermieri Familje” përgjatë kësaj periudhe.


Njohuri tërësisht të reja nga Bachelor

Masteri “Infermieri Familje” mbështetet në edukimin bazë infermior dhe u siguron studentëve aftësi të përparuara, të cilat u lejojnë atyre të punojnë në mjediset e kujdesit shëndetësor parësor duke u fokusuar në parandalimin e sëmundjeve, rehabilitimin dhe kujdesin infermior në mjediset e KSHP-së dhe në banesë. Si i tillë, programi nuk ka përsëritje të njohurive të marra në nivelin Bachelor.

Kriteret e Pranimi

Kandidatët duhet të zotërojnë diplomë “Bachelor”, diplomë të ciklit të dytë të studimeve ose diplomë të sistemit të vjetër në “Infermieri e Përgjithshme” ose “Mami”. Nëse diploma është lëshuar nga një universitet jashtë vendit, ajo duhet të jetë njohur dhe njehsuar nga struktura kompetente në vend.

Preferohen (kriter jo skualifikues) kandidatë që kanë eksperiencë/përvojë pune në Kujdesin Shëndetësor Parësor. Kandidatët do të vlerësohen sipas notës mesatare të studimeve të kryera si dhe do ti nënshtrohen intervistës.



Programi i Studimit

Programi Master Profesional “Infermieri Familje” organizohet në një vit akademik, me dy semestra, me kohë të plotë, me 60 ECTS në total. Plani mësimor i programit ka gjithsej 8 lëndë, praktikë profesionale (semestri I+II) dhe punim diplome.

Në semestrin e parë, studentët do të ndjekin lëndë që ofrojnë njohuritë bazë të infermierit të familjes, ndërsa në semestrin e dytë zhvillohen lëndët të cilat u lejojnë studentëve të zgjerojnë dhe thellojnë njohuritë dhe të kuptuarit mbi profesionin e infermierit të familjes. Praktika profesionale zhvillohet përgjatë gjithë vitit dhe studentët mësojnë të zbatojnë njohuritë dhe të zhvillojnë aftësitë në një mjedis praktik.

Semestri I	Semestri II
Infermieristika në Familje	Infermieri Familje (popullata specifike Geriatri + Psikiatri)
Menaxhimi infermioror i sëmundjeve kronike	Menaxhimi infermioror i sëmundjeve kronike
Infermieri e bazuar në evidencë	Vlerësimi klinik
Promocion shëndetësor	<i>Lëndë me zgjedhje:</i> Ergoterapi /Semiotika në logopedi
Praktikë profesionale në QSH	Praktikë profesionale në QSH

1. Lënda: Infermieri e Bazuar në Evidencë

Pedagogu: Dr. Albana Poloska

Nr. ECTS: 4 - 44 orë në auditor (Leksione: 1 ECTS/12 orë; Seminare: 2 ECTS/12 orë; Laborator: 1 ECTS/20 orë)

Përshkrimi:

Kjo lëndë synon të pajisë studentin me njohuritë bazë të lidhura me metodat kërkimore dhe praktikën e bazuar në evidenca. Prezantimi i njohurive përgjatë këtij kursi ndihmon studentët të kuptojnë metodat kërkimore, të vlerësojnë dhe përdorin gjetjet në vendimmarrjen klinike, të kuptojnë plotësisht dhe të përfshihen në praktikën e bazuar në evidenca. Të gjitha këto njohuri kontribuojnë për të përmirësuar aftësitë vendimmarrëse klinike të studentit dhe përmirësojnë rezultatet e pacientit. Prezantimi i tyre lejon që studenti të kuptojë domosdoshmërinë e ndërtimit të marrëdhënies interaktive midis teorisë, praktikës dhe kërkimeve shkencore gjatë praktikës së punës të Infermierit.

2. Lënda: “Infermieristika në familje. Konceptet, teoritë dhe aplikimet e saj”

Pedagogu: Dr. Etleva Kika – Smakaj

Nr. ECTS: 6, - 62 orë në auditor (Leksione: 2 ECTS/24 orë; Seminare: 3 ECTS/18 orë; Laborator: 1 ECTS/20 orë)

Përshkrimi:

Lënda synon të pajisë studentët me konceptet kryesore të Infermierisë familjare dhe diskuton dimensione të infermierit të familjes si dhe shëndetit të familjes. Këto definicione ndiqen nga shpjegime mbi kujdesin infermioror familjar përgjatë 4 përqsasve: sipas kontekstit, klientit, sistemeve dhe komponentëve shëndetësorë.

Ky kurs shtron truallin teorik të nevojshëm për praktikën e infermierit të familjes. Një vëmendje e veçantë i kushtohet variableve të cilët ndikojnë infermierinë familjare, rolet dhe përgjegjësitë si dhe pengesat në praktikën e infermierit të familjes. Adresimi i tyre lejon që studenti të kuptojë domosdoshmërinë e ndërtimit të marrëdhënies interaktive midis teorisë, praktikës dhe kërkimeve shkencore gjatë praktikës së punës të Infermierit.

Prezantimi i qasjeve sistematike për të zhvilluar plane veprimi për familjen duke ndërtuar mbi modelet tradicionale të proceseve infermierore krijon qasje dinamike dhe sistematike të vlerësimit infermioror. Gjithashtu kursi eksploron dhe analizon mënyra sesi t'a përfshish familjen në vendimarrje, si një hap kritik që ndihmon të fokusojë infermierin dhe familjen në identifikimin e shqetësimeve kryesore. Gjithashtu, lënda përmban raste studimi si shembuj për të demonstruar vlerësimin dhe ndërhyrjet e infermierit të familjes.

3. Lënda: Menaxhimi i Sëmundjeve Kronike

Pedagogu: Dr. Albana Poloska, Dr. Vjollca Ndreu, Msc. Miranda Cela

Nr. ECTS: 14 - 186 orë në auditor (Leksione: 3 ECTS/36 orë; Seminare: 5 ECTS/30 orë; Laborator: 4 ECTS/80 orë; Praktikë: 2 ECTS/40 orë)

Përshkrimi:

Kjo lëndë synon të pajisë studentin me formim të avancuar të njohurive lidhur me sëmundjet kronike të cilat kanë një ndikim të konsiderueshëm në jetën e njeriut si dhe në kujdesin shëndetësor. Kursi ofron një përmbledhje gjithëpërfshirëse të rolit të infermierit në kujdesin parësor, të zbatueshëm në kontekstin shqiptar, për menaxhimin e sëmundjeve jo të transmetueshme (SJT). Njohuritë që studentët do të marrin do të shërbejnë si një udhërrëfues për të kuptuar identifikimin e faktorëve riskues, kriteret e diagnostikimit dhe menaxhimin e sëmundjeve kronike brenda një ekipi multidisiplinar. Ky kurs trajton konceptet e kujdesit infermior në menaxhimin e këtyre patologjive, si edhe pengesat dhe mundësitë për parandalim. Në këtë kurs diskutohet rëndësia në rritje e vetëmenaxhimit shëndetësor dhe mënyra e realizimit të kujdesit shëndetësor në platformat elektronike.

4. Lënda: Promocioni Shëndetësor

Pedagogu: Dr. Valbona Bezhani

Nr. ECTS: 6 - 68 orë në auditor (Leksione: 3 ECTS/36 orë; Seminare: 2 ECTS/12 orë; Laborator: 1 ECTS/20 orë)

Përshkrimi:

Me shtimin e sëmundjeve kronike dhe presionit ndaj profesionistëve të shëndetit për të përmirësuar rezultatet e pacientëve, kërkesa për profesionistë të aftë në fushën e promovimit të shëndetit është më e fortë se kurrë më parë. Lënda prezanton edukimin e pacientit dhe promovimin e shëndetit si një funksion thelbësor të Infermierisë Familjare. Ky kurs ofron një pasqyrë të parimeve të promovimit të shëndetit, edukimit të pacientit dhe i mundëson studentit t'i përkthejë ato në praktikë. Nëpërmjet qasjeve të përdorura, studenti aftësohet që të përforcojë aftësi të mira të komunikimit efektiv, për të transmetuar më së miri të gjitha informacionet e nevojshme mbi shëndetin tek individët, grupet e popullatës në risk dhe të komunitetit. Gjithashtu kontribuon në lidhjen e hendekut midis teorisë dhe praktikës dhe i pajis studentët me mjetet e nevojshme për të aplikuar aftësitë në praktikën e promovimit shëndetësor. Metodologjia e lëndës përmban studime të rasteve, ushtrime dhe demonstrime në praktikë me shembuj se si konceptet teorike mund të zbatohen në situata të jetës reale. Në

praktikën klinike, studenti do të mund të kuptojë faktorët që rrisin promovimin e shëndetit dhe ulin riskun nëpërmjet zhvillimit të një marrëdhënieje afatgjatë me një pacient dhe familjen. Për më tepër, termat e këtij kursi adresojnë planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e programeve të promocionit, dhe diskutojnë aplikimet praktike të këtij procesi.

5. Lënda: Infermiera e familjes në popullata specifike

Pedagogu: Dr. Flora Zyberi

Nr. ECTS: 5 - 52 orë në auditor (Leksione: 2.5 ECTS/30 orë; Seminare: 2 ECTS/12 orë; Laborator: 0.5 ECTS/10 orë)

Përshkrimi:

Lënda synon të ofrojë njohuri teorike dhe shembuj praktikë sesi studentët mund të zbatojnë konceptet themelore të Infermierisë Familjare në popullatat e prekura me sëmundje geriatrike dhe psikiatrike. Kjo lëndë parashtron sfondin teorik të nevojshëm për praktikën e Infermierisë Familjare, por do të përdorë gjithashtu disa shembuj rastesh për të shpjeguar se si të vlerësojmë situatat familjare dhe të zhvillojmë plane veprimi familjare dhe ndërhyrje të përshtatura për këto popullata të synuara.

6. Lënda: Vlerësimi klinik

Pedagogu: Dr. Etleva Kika – Smakaj

Nr. ECTS: 5 - 82 orë në auditor (Leksione: 0.5 ECTS/6 orë; Seminare: 1 ECTS/6 orë; Laborator: 3.5 ECTS/70 orë)

Përshkrimi:

Përgjatë kësaj lënde studenti do të përgatitet se si të performojë një vlerësim sistematik të shëndetit të personit/pacientit, në mënyrë efektive dhe holistike. Një vlerësim i plotë fizik përbën bazën e të gjithë kujdesit infermieror. Kursi eksploron praktikat më të mira në marrjen e anamnezës së strukturuar dhe përmbledh aftësitë kryesore klinike të nevojshme, ekzaminimin fizik në funksion të vlerësimit, diagnostikimit, planifikimit dhe sigurimit të kujdesit proaktiv dhe të sigurt. Fokusimi tek interpretimi i gjetjeve të vlerësimit do të mundësojë dallimin midis gjetjeve normale dhe anormale, formulimin e diagnozave infermiore dhe referimin e pacientëve. Ndër të tjera studenti do të prezantohet me modelet e këshillimit, dokumentimin e gjendjes së pacientit dhe planit të kujdesit. Sesionet e orëve do të jenë një kombinim i prezantimeve/leksioneve, zhvillimin e laboratorëve me demonstrimin në kabinete dhe praktikë me pacientë realë

në ambjentet e qendrave shëndetësore dhe ambulancave. Qasjet e ofruara sigurojnë zhvillimin e aftësive të ekzaminimit fizik përfshirë auskultacionin, inspektimin, palpimin dhe perkusionin. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edhe bashkëpunimit të ekipit multidisiplinar në referimin dhe trajtimin e rasteve të pacientëve që hasen në praktikën e kujdesit shëndetësor parësor në Shqipëri.

7. Lënda: Terapia e punës, Ergoterapia (lëndë me zgjedhje)

Pedagogu: Dr. Vjollca Ndreu

Nr. ECTS: 2-18 orë në auditor (Leksione: 1 ECTS/12 orë; Seminare: 1 ECTS/6 orë; Laborator)

Përshkrimi:

Lënda synon të pajisë studentin me formimin e duhur mbi rolin e terapisë okupacionale në rehabilitim dhe me aftësitë bazë për adaptimin e ambienteve të punës dhe të shtëpise së pacientit me aftësi të kufizuara. Termat e kësaj lënde adresojnë modalitetet që përdor ergoterapia si: aktivitete të jetës së përditshme, teknika artizanale, profesionale, aktivitete kreative social-kulturore si dhe teknika të huazuara nga ergonomia pedagogjia. Ndër të tjera studenti do të njihet edhe me teknikat themelore të zhvendosjes së pacientit tetraplegjik, hemiplegjik. Lënda përfshin një ndërthurje të aspekteve teorike me ato praktike, duke bërë që të zhvillohen aftësitë themelore të studentëve për ndërveprime brenda ambienteve profesionale të kujdesit shëndetësor.

8. Lënda: Semiotika në Logopedi (lëndë me zgjedhje)

Pedagogu: Dr. Valbona Bezhani

Nr. ECTS: 2 - 18 orë në auditor (Leksione: 1 ECTS/12 orë; Seminare: 1 ECTS/6 orë; Laborator)

Përshkrimi:

Ky modul synon të pajisë studentët me formim të përgjithshëm, me konceptet bashkëkohore të semiotikës logopedike, t'i njohë ata me simptomat e patologjive kryesore të komunikimit dhe të folurit dhe t'i përgatisë për bërjen e bilanceve gjuhësore.

“Bazat e Semiotikës dhe ligjet e saj” paraqet interes në lidhje me atë, që gjithçka që na rrethon janë shenja specifike: dukuritë e natyrës, programet kompjuterke, piktura, muzika dhe, sigurisht, gjuha, si në nivelin artistike, ashtu dhe në gjendjen e saj të natyrshme. Njeriu jeton në botën e shenjave, përdor shenjat dhe në

situata të caktuara vetë përfaqëson një shenjë. Të ecurit e njeriut, veçantia e figurës së tij, timbri i zërit, forma e qethjes - ja pra një komplet i plotë shenjash, sipas të cilave ne ia qëllojmë mënjëherë një të njohuri. Shkenca që merret me studimin dhe interpretimin e shenjave dhe sistemeve shenjore, të krijuara me bazën e tyre, quhet Semiotikë. Sistemi shenjoy - është një sistem, që transmeton një informacion, të ndryshëm nga energjia. Ai ekziston objektivisht, pavarësisht nga vëzhguesi. Një prej sistemeve më të rëndësishme të sistemit shenjoy, të krijuar prej njeriut është gjuha natyrale, ose gjuha e folur.

9. Praktika

Pedagogu: Pedagogë mbikqyrës dhe infermierët referentë të QSH sipas marrëveshjeve

Nr. ECTS: 10 - 250 orë në auditor

Përshkrimi:

Qëllimi i kësaj lënde është t'u sigurojë studentëve një mundësi për të forcuar aftësitë e tyre infermierore në fushën e Infermierisë Familjare, për të zbatuar njohuritë e tyre në praktikën klinike dhe për të demonstruar kompetencë në aftësitë dhe procedurat praktike. Kjo do t'i përgatisë ata për rolin e ardhshëm të infermierit të familjes në mjedisin e kujdesit komunitar. Në këtë lëndë, studentët do të kalojnë gjithsej 8 javë në qendrën e trajnimit, tre në fund të semestrit të parë dhe pesë në fund të semestrit të dytë. Ata do të qëndrojnë me javë të plota në një qendër të kujdesit shëndetësor ose ambulancë nën mbikëqyrjen e një mentori në klinikë. Në mes të praktikës do të organizohet një seminar ku studentët mund të reflektojnë me njëri-tjetrin lidhur mbi përvojat dhe sfidat e tyre.

Mbështetja e Projektit Shëndet për të Gjithë (Health for All Project - HAP)

Masteri Profesional “Infermieri Familje” mbështetet nga Shëndet për të Gjithë/ Health for All Project, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC. Në mbështetje të masterit profesional “Infermieri Familje”, HAP ka bërë të mundur:

- Përmirësimin e infrastrukturës mësimore përmes ndërtimit të laboratorit simulues të praktikës klinike pranë FSHMT i cili synon aftësimin sa më të mirë praktik të studentëve.
- Ekspertizë teknike për grupin multidisiplinar të punës për draftimin e kurrikulës së masterit. Grupi i punës, i përbërë nga përfaqësues të MSHMS, UMT, FSHMT, Urdhri i Mjekut, Urdhri i Infermierit si dhe ofrues të Kujdesit Shëndetësor Parësor) është mbështetur nga ekspertë ndërkombëtarë dhe lokalë.
- Rritjen e kapaciteteve të lektorëve përgjegjës përmes sigurimit të literaturës së referencës, trajnimit nga ekspertë vendas e ndërkombëtarë, vizita studimore pranë institucioneve ndërkombëtare arsimore.
- Ofrimin pa pagesë të materialeve mësimore për studentët, përpara fillimit të çdo moduli.
- Përmirësimin e infrastrukturës në qendrat shëndetësore të kujdesit parësor ku do të zhvillohen praktikat mësimore për studentët. Supervizorët e praktikës dhe ekipeve infermierore të QSH që do të ofrojnë praktikat mësimore në infermieri në familje janë trajnuar me synim aftësimin praktik të studentëve.



Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike

Adresa: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”

E-mail: fshmt.info@umed.edu.al

Website: <https://fshmt.umt.rash.al>

Facebook: [Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike - Universiteti i Mjekësisë](#)

Masteri Profesional “Infermieri Familje” mbështetet nga Projekti “Shëndet për të Gjithë” i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



Swiss TPH 
Swiss Tropical and Public Health Institute